



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:139793

Datë: 28.06.2019

Numri i dokumentit: 00384389

PKR.nr.88/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri dhe anëtarëve të trupit gjykues gjyqtarëve Ramiz Azizi dhe Rilind Sermahaj, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të akuzuarve: A. H. me mbrojtësin e tij sipas sipas autorizimit av.Vehbi Ismajli, M. SH. me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Fitim Kosumi dhe V. K., të cilin i mbron sipas autorizimit av.Sevdail Robelli nga Gjilani, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 329 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm : KPRK-së) si dhe i akuzuari A. H. si i vetëm për shkak të veprës penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi , ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo maerieve plasëse, nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I. nr. 16/2018 të datës 01.03. 2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 14 qershor të vitit 2019, nxjerr dhe në prani të prokurorit të shtetit Mr.sc.Agron Uka, si dhe të të akuzuarit Veton Kryeziu me mbrojtësin e tij, kryetari i trupit gjykues në të njëjtën ditë publikisht shpallë këtë,

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari V. K. nga i ati dhe e ëma – me mbiemër të vajzërisë, I lindur më në Gjilan, ku edhe e ka vendbanimin, me adresë lagja “ Arbëria “ rruga “..... “ nr. 2, posedues i telefonit mobil me SIM kartelë 044, shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, ka qenë i punësuar në bastoren sportive me seli në Gjilan, me të ardhura mujore 250 -300 Euro në muaj, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij, I tërhiqet vërejtja se gjer në përfundimin e kësaj procedura penale është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën me shkrim ose verbalisht, në rast të ndërrimit eventual të vendbanimit ose vendqëndrimit të tij, nën kërcënim të pasojave ligjore,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datën 02 janar të vitit 2018, në mes orës 22,00-23,00,në Gjilan, në lagjen “Arbëria” të pandehurit me përgatitje dhe dashje paraprake, në bastoren e të pandehurit V., merren vesh –përgatiten -

përpilojnë planin për aktivitetin e tyre në bashkëveprim për të kryer veprën penale dhe njëkohësisht në masë të konsiderueshëm dukshëm kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale, ashtu që të njëjtit me qëllim që t'i sjellin vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme duke përvetësuar pasurinë e luajtshme, me anë të përdorimit të forcës dhe armës për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, ashtu që me datë 03.01.2018, rreth orës 01:55 minuta pas mesnatës, në kazinon "Kajot" në rrugën e Ferizajit në Gjilan, në bashkëveprim dhe me dashje kanë përvetësuar pasurinë e luajtshme, duke përdor forcën dhe armën për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, kanë përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme paratë në shumë prej 670 Euro, ashtu që të pandehurit me paramedim dhe me dashje të maskuar kanë kryer grabitje me forcë në kazinon "Kajot" duke hap derën me forcë nën kërcënim të armës dhe thikës, kështu që posa kanë hyrë në kazino kanë bërë shtrinu dhe i pandehuri A. është drejtuar në drejtim të punëtorit të kazinos edhe atë të dëmtuarit I. K. nën kërcënimin e armës ia merr portofolin e punës me para në shumën e lartcekur, kurse i pandehuri Meriton duke u kërcënuar me thikë nisat në drejtim të pandehurit V. kinse i njëjti ishte lojtar në kazino dhe nga xhepi i pantollonave ia merr portofolin në të cilin kishte 470 euro dhe pastaj të pandehurit A. dhe M. ikin nga vendi i ngajrjes, ndërsa i pandehuri V. mbetet në kazino dhe në mëngjes i pandehuri A. ia kthen portofolin me 470 euro të pandehurit V., ashtu që pas punës operative të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, të pandehurit kapen dhe arrestohen me datën 11.01.2018.

-ashtu që me këto veprime kriminale i akuzuari Veton në bashkëkryerje me dy të akuzuarit tjerë ka kryer veprën penale të **grabitjes nga neni 329 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,**

Andaj, në bazë të dispozitave të cituara si dhe të dispozitave vijuese nga nenet : 4,7, 41, 43, 45, 46, 73-76 dhe 83 të KPRK-së si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm KPP-së) të akuzuarin V. K.,

E G J Y K O N

me dënime kumulative dhe atë :

-me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, të cilin dënim duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm

dhe

-me dënim me gjobë në shumën prej pesqind (500) Euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në afat prej dy muajve në këste të barabarta prej nga 250 Euro,

mirëpo, nëse eventualisht ky i akuzuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit ky dënim

i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzetepesë(25) ditëve, të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e dërgimit të ftesës për mbajtje ose vazhdim të dënimit lëndor, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm,

II. Në kuptim të nenit 83 paragrafi 1. të KPRK-së të akuzuarit V. K., A. H. dhe M. Sh. në dënimin e shqiptuar do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim duke filluar nga data 11 janar 2018 e deri më datën 06 korrik 2018.

III. Detyrohet i akuzuari në fjalë që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale edhe atë përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **njëqind (100) Euro,** ndërsa në emër të **taksës për kompensimin e viktimave shumë prej nga pesëdhjetë (50) Euro,** të gjitha në afat prej 30 ditëve, nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

IV. Aprovohet pjesërisht kërkesa pasurore juridike e të dëmtuarit I. K. nga Gjilani, ashtu që i akuzuari V. K. nga Gjilani, **detyrohet** që të njëjtit t'ia paguajnë shumën prej **gjashtëqindeshtatëdhjetë (670) Euro** edhe atë në mënyrë përpjestimore me dy të akuzuarit tjerë A. H. dhe M. Sh., e të cilën shumë të akuzuarit ia kanë marrë me veprim kriminal për të cilën edhe janë shpallur fajtorë, në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën përcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Për pjesën tjetër të kërkesës pasurore juridike lidhur me dëmin moral në shumë prej **pesë mijë (5,000) Euro** pala e dëmtuar udhëzohet në **kontest të rregullt civil**.

A r s y e t i m

Organi i ndjekjes penale kundër të akuzuarve : A. H., M. Sh. dhe V. K. që të tre nga Gjilani, për shkak të dyshimit të bazuar mirë ka ngritur aktakuzë në drejtim veprës penale në bashkëkryerje nga neni 329 paragrafi 3.lidhur me nenin 31 të KPRK-së ndërsa vetëm për të akuzuarin A. edhe veprës penale nga neni 372 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të lëndës së kthyer në rigjykim dy të akuzuarit A. H. dhe M. Sh. e kanë pranuar fajësinë për veprat penale lëndore, ndërsa i akuzuari V. me mbrojtësin e tij gjykatës i kanë propozuar që t'ia mundësojnë shtyrjen e seancës për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjykata me aktvendim të veçantë e ka veçuar lëndën penale përkitazi me të akuzuarin V. K., kurse për dy të akuzuarit tjerë gjykata ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor sipas dy marrëveshjeve për pranimin e fajësisë duke i shpallë fajtorë dhe dënuar si në aktgjykimin e dates 10 qershor 2019 me numër të protokollit **PKR.nr. 60 /2018**.

Meqë gjykata nuk është njoftuar për rezultatin e negociimit apo të kundërtën, ndërsa palët janë paraqitur ditën kur edhe ka qenë e caktuar mbajtja e seancës së shqyrtimit gjyqësor, gjakata ka konsideruar por edhe palët e kanë njoftuar se nuk ka pasur sukses negociimi.

Pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij, me vetëdije të plotë dhe vuillnet të lirë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale të grabitjes dhe atë sipas përshkrimit faktik dhe kualifikimit juridik sin ë aktakuzën lëndore.

Këtë nuk e ka kundërshtuar mbrojtësi i autorizuar i tij, por as prokurori i shtetit.

Gjykata në kuptim të nenit 326 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 248 paragrafi 1. të KPP-së me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në fjalë përkitazi me kryerjen e veprës penale të grabitjes së bashku me dy të akuzuarit tjerë, të cilët veç janë gjykuar sipas aktgjykimit të veçantë me numër të cekur më lartë.

Gjatë fjalës përfundimtare prokurori i shtetit ka mbetur pranë aktakuzës lëndore me arsyetim se ka prova të mjaftueshme për mbështetje e dyshimit të bazuar mirë, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarin V. ta shpall fajtor dhe dënoj sipas dispozitave të KPRK-së, e duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Mbrojtësi i të akuzuarit gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se gjendja faktike tanimë nuk është kontestuese, mirëpo gjykatës i ka propozuar që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit t'i ketë parasysh këto rrethana lehtësuese : pranimin e fajësisë, pendimin e sinqertë, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, se është i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij dhe se është i moshës relativisht të re. Kështu që duke i pasur parasysh këto rrethana gjykatës i ka propozuar që në kuptim të dispozitave nga nenet 73-76 e veçanërisht të dispozitës së nenit 75 të KPRK-së të akuzuarit t'ia shqiptoj një dënim nën minimumin e posaçëm me arsyetim se edhe me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

Gjykata në bazë të provave në shkresa të lëndës duke përfshirë edhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit V. ka vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale në bashkëkryerje sipas nenit 329 paragrafi 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke e shpallur fajtor për të njëjtën.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh këto rrethana lehtësuese : pranimin e fajësisë, pendimin e sinqertë, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, se është i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij dhe se është i moshës relativisht të re ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilat përbëjnë edhe rrethanat veçanërisht lehtësuese në kuptim të nenit 75 paragrafi 3 të KPRK-së të akuzuarin V. e ka gjykuar me dënimet kumulative si në dispozitiv edhe atë nën minimumin e posaçëm të paraparë për veprën penale lëndore edhe atë si dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje të plotë se në kuptim të nenit 41 të KPRK-së do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit si ndaj të akuzuarit ashtu edhe ndaj qytetarëve potencial.

Meqë i akuzuari sikurse dy të akuzuarit tjerë të cekur më lartë me rastin e pranimit të fajësisë kanë pranuar edhe kryerjen e kompensimit të kërkesës pasurore-juridike përkitazi me dëmin financiar në shumën prej 670 Euro, e kjo shumë është e përfshirë edhe në përshkrimin faktik të veprës penale lëndore, gjykata është përcaktuar që të vendosë në mënyrë meritore lidhur me këtë pjesë të kërkesës, ndërsa për pjesën tjetër të kërkesës përkitazi me dëmin moral prej 5,000 Euro të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Gjykata pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë, kurse ato shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë andaj edhe në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-së më datën **14 qershor** të vitit **2019** ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm. Në dënimet e shqiptuara në kuptim të nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-së të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP, ndërsa për taksën e kompensimit të viktimave të krimit në kuptim të nenit 39 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Nga të cekurat e më lartë, në kuptim të nenit 233 dhe 365 të KPP është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr. 88/2019, më dt.14 qershor të vitit 2019

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymeri

Kryetari i trupit gjyqësor,
Aziz Shaqiri

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të Rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ekzemplarit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

VËREJTJE: Pasi që palët kanë heqë dorë shprehimisht nga e drejta në ankesë në procesverbal, aktgjykimi lëndor bëhet i plotfuqishëm – formës së prerë më datën **14 qershor 2019**.

Numri i lëndës: 2019:139793
Datë: 28.06.2019
Numri i dokumentit: 00384389